Bazuar në dispozitat e nenit 108/A par. 1 dhe 3.2 të i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92-së dhe dispozitat nga neni 4 i Rregullave për parashtrim të ankesave – FO2, N.P.G "Malsia" Gurakoc, Gurrakoc 600049622 Republika e Kosovës në cilësi të palës së interesuar që ka interes juridik-material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit lidhur me këtë lëndë, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues – Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Dhënie të Kontratës të datës e kontratës publike me datë 18/12/2020 – Letër standarde për tenderuesin e eliminuar të Autoritetit Kontraktues dhe Vendimit -përgjigje në Kërkesën për Rishqyrtim të datës 24/12/2020 paraqet:

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Ministria e Punëve të Brendshme, Ndërtesa Qëndrore e MPB-së Rr. Luan Haradinaj 10 000 Prishtinë Republika e Kosovës;

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. 214-18-9663-1-1-1 dhe

Numër i brendshëm: 214 – 18 - 029- 111

Sa i përket tenderit për: 'Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteve - ritender'

ANKESË

1. **Identifikimi i ankuesit** *N.P.G "Malsija" Gurakoc, Gurrakoc 600049622 Republika e Kosovës*

Gurrakoc *10000*
044 13 89 96

Malsija NPG <info@malsija.company
(Adresa elektronike)

05//01/2021

NPTGN 80090706 MALSIJA GURAKOC-ISTOG

Zef Malsija

Zef Malsija

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

☐ Njoftimi për Kontratë i publikuar në web faqen e platëformës elektronike të KRPP-së dt. 26/12/2018;
☐ Afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë 15/02/2019 ora 14:00, Zyra e Prokurimit
☐ Hapja e ofertave nga përbërja e komisionit të AK-së në prezencën e ofertuesve është bërë më datë 15/02/2019 ora 14 :00:, Zyra e Prokurimit,
☐ Kriteri për dhënien e Kontratës: **Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët;**
☐ Paraqitja e mjeteve juridike
☐ Kërkesa për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues më 23/12/2020
☐ Vendimi – përgjigje në kërkesë për rishqyrtim i datës 24/12/2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] **Jo** [ ]

Në momentin e hapjes së ofertave nuk ka pasur vërejtje

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [po] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Kërkesë për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues Ministria e Puneve të Brendshme kemi parashtruar më datë 23/12/2020.
Përgjigjen – Vendimin e kemi prauar më datë 24/12/2020

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjatë kontekstit pa 108A te LPP-së.

Autoriteti kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme në Vendimin – Përgjigjen mbi refuzimin e kërkeses tonë për rishqyrtim të parashtruar më 24/12/2020 në asnjërin nga pretendimet tona nuk ka dhënë përgjigje.
Në pikat kryesore kur është në pyetje specifikimet teknike neni 28 Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Specifikimet teknike) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92, dhe neni 20 i RRUOPP-së (Specifikimet Teknike).
Mandej shkputjet e paraqitura në vazhdimin, përkatësisht zgjatjen e afatit të vlefshmërisë –validitetit të ofertave si dhe vazhdimin e vërtetimit të sigurisë ofertave që të gjitha ofertat kanë pasur ndërprerje të këtyre dy dokumenteve.
"Megjithatë, është e rëndësishme që të ketë kontinuitet midis afatit të skaduar dhe atij të ri, për këtë arsye në këtë dispozitë thuhet: "para datës së skadimit...."

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.
Është shkelur neni 1 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (qëllimi,shfrytëzimi më efikas, më transparent dhe më i drejtë i fondeve publike) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92

- *Është shkelur neni 7 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Barazia në trajtim / jo – Diskriminimi) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,*

- *Është shkelur neni 39 i RRUOPP-së (Sqarimi i Tenderëve).*

- *Është shkelur neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve).*

- *Është shkelur neni 41 i RRUOPP-së (Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve).*

- *Është shkelur neni 28i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Specifikimet teknike) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,*

- *Është shkelur neni 20 i RRUOPP-së (Specifikimet Teknike)*

- *Është shkelur neni 70 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Standardet për sigurimin e Cilësisë) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,*

Pas ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të dokumenteve të cilat e përbëjnë dosjen e tenderit për aktivitetin e prokurimitme titull: Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteve-ritender me nr. të aktivitetin të prokurimit: 214-18-9663-1-1-1 dhe Nr. i brendshëm: 214 - 18- 029- 111
Sa i përket tenderit për: Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteve-ritender Ne në cilësinë e operatorit ekonomik të interesuar konsiderojmë se shpallja e Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues – Dhënie e Kontratës publike dhe Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar më datë 28/08/2020 i publikuar në ueb faqen e platformes elektronike të KRPP-së me datë 28/08/2020 nga ana e Autoritetit Kontraktues është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së si dhe të gjitha aktet tjera nën ligjore që kanë të bëjnë me prokurimin publik në Republikën e Kosovës. Në këtë mënyrë e ka dëmtuar rendë interesin material-financiar të kompanisë në fitimin e kontratës publike në mënyrë të rregullt dhe ligjore.
Shkeljet e dispozitave ligjore nga AK të cilat janë konstatuar nga operatori ekonomik "N.P.G "Malsija" Gurakoc, Gurrakoc 600049622 Republika e Kosovës

- Është shkelur neni 1 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (qëllimi,shfrytëzimi më efikas, më transparent dhe më i drejtë i fondeve publike) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92

- Është shkelur neni 7 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Barazia në trajtim / jo – Diskriminimi) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,

- Është shkelur neni 39 i RRUOPP-së (Sqarimi i Tenderëve).

- Është shkelur neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve).

- Është shkelur neni 41 i RRUOPP-së (Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve).

- Është shkelur neni 28i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Specifikimet teknike) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,

- Është shkelur neni 20 i RRUOPP-së (Specifikimet Teknike)

- Është shkelur neni 70 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Standardet për sigurimin e Cilësisë) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj

Operatorit ekonomik oferta e të cilit është propozuar që të shperblehet me kontratë publike Grup i Operatorëve Ekonomik G.S.G SH.P.K. & KIG d.d. &KIG d.o.o Hyzri Talla, Qendra Tregtare 10000 Prishtinë mungojnë ose janë jo të rregullta këto dokumente:

- Test raporti për targa e ka Kig, ky test raport është i lëshuarnga ZAK (ZAVOD ZA GRADBENISTVO) ZAK nuk është i akredituar për lëshim të certifikatës ISO 7591:1982, ky institucion është vetëm për ndërtimtari,

- Auditimin nuk e ka për tri vitet por vetëm 2016, 2017

- Qertifikatën 3 M e ka për shtetin Slloven dhe Gjerman

- Marrëveshja (kontratat e bashkpunimit i mungon konzerciumi kanë vetëm Deklarata nën betim GSG SHPK e veqantë dhe KIG dd e veqantë mungon deklarata e e veqant KIG doo si dhe e përbashkët e konzerciumit të tre partnerëve të përbashkët e dosjes së tenderit

- Validiteti i ofrtës dhe vërtetimi i sigurimit të ofertës i mungon mangësi e cila është trajtuar në njëren nga seacat kryesore të të panelit shqyrtues të OSHP-së

- Formulari i tenderit jo në rregull i pa plotësuar dhe i pa firmosur dhe vulosur nga konzerciumi as nga lideri dhe çmimi i shenuar vetëm me shifra dhe jo me germa

KIG dorëzon mostrat nga ZAK LJUBLJANA të vitit: 13/01/2015, 13/07/2010, 25/10/2005

- Liderit i mungon çertifikata e regjistrimit biznesit dhe informatat mbi biznesin në dosje ka vëtëm çertifikatën e TVSH dhe nr. fiskal

- Te deklarata përfaqesues ligjor për dy firmat KIG KGA doo dhe KIG dd paraqitet Drejtor dhe zyrtar ligjor dhe për të dy kompanitë i firmos dhe vulos.

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së.

Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

- Është shkelur neni 6 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (ekonomiciteti dhe efikasiteti i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92
Paragrafi i pare i këtij neni thotë:

1. "Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit".

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe / ose profesionale

Konstatimet tuaja në Letër standarde për tenderuesin e eliminuar nuk qendrojnë, sepse të gjitha certifikatat të cilat ju i përmendni në këtë letër janë të bashkangjitur me ofertë e cila është dorëzuar komplet me të gjitha dokumentet tjera. Këto certifikata nuk po i numroj një nga një, por edhe një herë kopjet e tyre do t'ia bashkangjesim kësaj ankese.

Shkelja me e madhe ka të bëjë me:
- Është shkelur neni 28 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Specifikimet teknike) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,

- Është shkelur neni 20 i RRUOPP-së (Specifikimet Teknike)

- Është shkelur neni 70 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Standardet për sigurimin e Cilësisë) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,

Neni 28

Specifikimet teknike i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,
Paragrafët 2, 4dhe 7 mjaft mire e trajtojnë çshtjen e Specifikimeve teknike

2. "Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

4. Autoritetet kontraktuese do të formulojnë specifikimet teknike duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës që implementon një standard Evropian, (ii) një standardi Evropian. (iii) një miratimi teknik Evropian, (iv) një specifikimi të përbashkët teknik, (v) një standardi ndërkombëtar apo (vi) çfarëdo referimi tjetër teknik të nxjerrë nga organet Evropiane për standardizim.

7. Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij neni ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët "ose ekuivalent"

20. Specifikimet Teknike Është shkelur neni 20 i RRUOPP-së (Specifikimet Teknike)

Po ashtu njejtë e trajton edhe neni 20 me paragrafët 20.3, 20.4, 20.5, 20.6, 20.7,

20.3 Specifikimet teknike do të përshkruajnë dhe përkufizojnë, në mënyrë jo-diskriminuese, karakteristikat e obligueshme të objektit të kontratës, siç janë cilësia, performanca, kërkesat e dizajnit, dimensionet, siguria, sigurimi i cilësisë, terminologjia, simbolet, testimi dhe metodat e testimit, paketimi, shënimi dhe etiketimit. AK do të tregojë nëse specifikimet teknike të parashtruara janë obligative apo kërkesa minimale. Përdorimi i standardeve mund të përfshijë standarde të sigurimit të cilësisë siç është cekur në Nenin 70 të LPP-së.

20.4 Specifikimet /TER do të jetë e qartë, e saktë dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të panevojshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Ato duhet të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë dyshime rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara.

Sa i përket direktivave të BE-së, parimi theksohet si në vijim:
"Specifikimet teknike do të ofrojnë qasje të barabartë për tenderuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të paarsyeshme në hapjen e konkurrencës së prokurimit publik."

20.5 Një specifikim teknik do të theksohet, për aq sa është e mundur, duke ju referuar standardeve të mirënjohura por mund të formulohet gjithashtu në aspektin e performancë apo kërkesave funksionale. Një AK mund të përdorë standardet për karakteristika të caktuara dhe performancë ose kërkesa të funksionalitetit për karakteristika tjera.

20.6 Referencë në një standard të njohur:

Hierarkia e Standardeve që do të referohet gjatë formulimit të specifikimeve teknike

(1) - një standard i Kosovës që implementon një standard të Evropës,

(2) - një standard Evropian,

(3) - një aprovim teknike Evropian,

(4) - një specifikim i përbashkët teknik,

(5) - një standard ndërkombëtarë dhe/ose

(6) – çdo sistem tjetër i referencës teknike i prodhuar nga organet Evropiane të standardizimit.

Re (1): Agjencia Kosovare për Standardizim implementon standardet Evropiane në Kosovë.
Re (2): Standardet Evropiane aprovohen nga Komisioni Evropian për Standardizim (CEN), www.cenorm.be, dhe Komisioni Evropian për Standardizimin Elektro-teknik (CENELEC), www.cenelec.org.
Re (3): Aprovimet Evropiane teknike (sektori i ndërtimtarisë) nxjerrën nga organe të aprovimit në Shtetet Anëtare të BE-së në bazë të "kërkesave esenciale" të përbashkëta.
Re (4): Specifikim i përbashkët teknik do të thotë një specifikim teknik i përcaktuar sipas një procedure të BE-së.
Re (5): Standarde ndërkombëtare janë për shembull ISO, www.iso.org, ASTM, www.astm.org etj.
Re (6): ndonjë referencë tjetër të prodhuar nga organet Evropiane.
20.7 Nëse nuk ekziston një standard i aplikueshëm ose standarde të tilla nuk do të ishin efikase në aplikim për arsye teknike apo ekonomike – AK mund të referohet te:

- një standard i Kosovës, ose

- një aprovim teknik të Kosovës

Nga këto përshkrime të specifikimeve teknike si në Neni 28
Specifikimet teknike i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92, po ashtu edhe në i RRUOPP-së (Specifikimet Teknike) neni 20 shumë kjartë shihet se ju keni qasur gabimisht hartimit të specifikimeve teknike për aktivitetin e lartcekur të prokurimit.

Si është e mundur të mirret një standard i në shteti tjetër, konkretisht shtetit të Gjermanisë për prodhimin e targave të automjeteve (që i referohet edhe rregullorës për regjistrimin e automjeteve dhe targave gjermane)

Me datë 18/07/2019 plotësisht me arsye e keni anuluar këtë aktivitet të prokurimit dhe keni shkruar këtë arsyetim:
"Gjatë fazës së rivlerësimit është kuptuar se kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale edhe specifikimet teknike të përcaktuara në dosjen e tenderit sipas standardit DIN 74069 (që i referohet edhe regullorës për regjistrimin e automjeteve dhe targave gjermane) është në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Specifikimet teknike) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92, si dhe të nenit 20 Specifikimet Tenike të RRUOPP, gjë e cila është e konfirmuar edhe me interpretimin ligjor i dates 11/07/2019 nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP).
Prandaj ky aktivitet i prokurimit ANULOHET bazuar në nenin 62, paragrafi 1.1 të ligjit për Prokurim Publik".

Është krejtsisht e pa kuptueshme se si keni mundur që për këtë aktivitet të prokurimit të

propozoni që oferta e operatorit ekonomik Grup i Operatorëve Ekonomik G.S.G SH.P.K. & KIG d.d. &KIG d.o.o Hyzri Talla, Qendra Tregtare 10000 Prishtinë të shpërblehet me kontratë publike edhe përkundër parregullësive të evidentuara gjatë fazes së vlerësimit të ofertave si dhe pas nxjerrjes së konstatimit të KRPP-së.
Por sido që të jetë nëse edhe më tutje vazhdoni të bëni ri-vlersimin e ofertave, ofertën të cilen e ka dorëzuar operatori ekonomik"N.P.G "Malsia" Gurakoc, Gurrakoc 600049622 duhet të trajtoni ofertë të përgjegjsheme me çmimin më të ulët dhe të shpërbleni me kontratë publike.

Me rastin e shikimit në dokumentet e operatorit ekonomik i cili është propozuar që të shpërblehet me kontratë hasa një një numer të madh të dokumenteve në gjuhen sllovene.

Në rubriken e pyetjeve të shpeshta të KRPP-së gjendet edhe kjo pyetje:

A duhet të refuzohet tenderi apo të kerkohet sqarime sipas 72, i cili ka sjellë dokumente në gjuhë tjetër nga ato të lejuara me LPP?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237,

Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP sqaron si në vijim:
Neni 13.4 i LPP-së në lidhje me gjuhët zyrtare të procedurës së tenderimit përcakton:

"Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze".

Kjo dispozitë në mënyrë të qartë përsëritet në format standarde të miratuara në bazë të LPP-së.

Sipas dispozitave të lartpërmendura tenderët mund të dorëzohen vetëm në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Ligji siç shihet nuk lejon ndonjë përjashtim në rastin e lartpërmendur.

Në LPP dhe legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me ligj, nuk përcaktohet zgjidhja për AK-në se si duhet të veprojë në rast se një tenderues paraqet ndonjë nga dokumentet e tenderit në një gjuhë tjetër nga ajo e autorizuar me nenin 13 të LPP-së.

Si rrjedhojë, bazuar në nenin 13 të LPP-së dhe format standarde (dokumentet e tenderimit), KRPP ofron këtë opinion:

Në rast se një operator ekonomik dorëzon specifikimet teknike në një gjuhë tjetër (psh. në Gjuhën Gjermane, Italiane apo cilëndo gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me këtë ligj), me pasojë që Komisioni i Vlerësimit nuk është në pozitë që të vlerësoj tenderin.

Në këtë rast, duhet të merren parasysh si në vijim:

1) neni 13.4 nuk lejon asnjë përjashtim nga gjuhët e përmendura. As format standarde të cilat imponojnë AK për të miratuar të gjitha ose disa nga gjuhët e përcaktuara në nenin 13.4. Përveç kësaj, duhet të ceket se LPP-ja, përveç gjuhës shqipe dhe serbe, tashmë e lejon përdorimin edhe të Gjuhës Angleze. Zgjedhja e ligjvënësit është bërë në faktin se, duke qenë Gjuha Shqipe dhe Serbe jo shumë e përhapur, Gjuha Angleze lejon pjesëmarrjen e Operatoreve të huaj Ekonomik, pasi që është gjuha që përdoret ndërkombëtarisht;

2) në rastin e përmendur, është menduar, se specifikimet teknike të produktit të ofruar nga OE në fjalë do të duhet të ishin në dispozicion, jo vetëm në gjuhën e tenderuesit, por edhe në gjuhën angleze. Sipas përvojës, në fakt, specifikimet teknike të çdo produkti që ka relevancë ndërkombëtare zakonisht janë në dispozicion në gjuhën angleze.

Kur ato nuk janë në dispozicion, OE në fjalë duhet të ketë dorëzuar, në vend të specifikimeve teknike në gjuhën e tenderuesit, një përkthim të certifikuar në anglisht për specifikimet teknike.

Pra, sjellja e OE që sjellë dokumente në gjuhë tjetër nga ato të lejuara me ligj, është neglizhencë dhe plotësisht e pavarur nga një dispozitë e veçantë në dokumentet e tenderit.

3) Dispozita e lartpërmendur e LPP-së e cila përcakton përdorimin e gjuhëve gjatë procedurave të tenderimit është e përshkruar në mënyrë që të vë komisionin vlerësues në pozitë më të mirë për të vlerësuar përmbajtjen e tenderit.

Në parim, prodhimi i dokumenteve i cili nuk është i shoqëruar me një përkthim zyrtar është ekuivalente me mos-prodhim të të njëjtit, pasi që pengon autoritetin kontraktues që të ketë njohuri të menjëhershme dhe të drejtpërdrejtë për elementet përkatëse të tenderit.

4) parimi i lartpërmendur mund të ketë një shmangie kur nuk ka të bëjë me pjesë thelbësore te tenderit, si për shembull broshura, anekse ose dokumente të tjera që kanë karakter jo të detyrueshëm, por thjesht dorëzohen nga OE për të përshkruar më mirë produktin e ofruar. Në të kundërt, në rastin e përmendur, OE ka paraqitur në një gjuhë tjetër specifikimet teknike të cilat përfaqësojnë një pjesë thelbësore dhe të nevojshme për pranimin e tenderuesit.

Kështu, duke pasur parasysh konsideratat e lartpërmendura, tenderi i cili ofron specifikimet teknike në gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me LPP, duhet të përjashtohet.

Ndërsa për cilindo dokument tjetër të kërkuar si dëshmi sipas nenit 65-71 të LPP-së, në përputhje me nenin 72 të LPP-së mund të kërkohet nga OE që të dorëzojë një përkthim zyrtar të të njëjtit dokument.

Ju në Letër standarde për tenderuesin e eliminuar në

Arsyetim keni thënë:

"Ju jeni diskualifikuar, tenderi i juaj është refuzuar për këto arsye:
Komisioni i ri-vlerësimit të ofertave pas kontrollimit dhe analizimit të ofertës se këtij

operatori ekonomik se sa i përket dokumentacionit të kërkuar sipas dosjes se tenderit, ky operator ekonomik nuk posedon tërë dokumentacionin e kërkuar.
Autoriteti kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme, ka vepruar në harmoni të plotë me LPP-në dhe nenet: Neni 7 Barazia në Trajtim/Jo diskriminimi, ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim të gjithë operatorët ekonomik ofertues në harmoni të plotë me nenin 59, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tendërve, dhe nenin Nenin 41 të RRUOPP-së ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tendërve; pika 41.1 dhe 41.3 Parimet kyesore të procedures së vlerësimit sipas LPP, nënpikat 1,2,3,4,5,6,7 dhe 8 dhe në harmoni me nenin 60 kriteret për dhënien e kontratës me kriteret evendosura në Njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit duke trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë OE-të.
Arsyet mi eliminimin:
Oferta e juaj është administrativisht e pa përgjegjeshme, sepese ju nuk keni ofruar vazhdimin e sigurimit të ofertave dhe nuk keni ofruar vazhdimin e validitetit të ofertave sipas kërkesave të AK dhe rrjedhimisht konsideroni se keni hequr dorë nga oferta juaj".

Si t'iu dërgojmë vazhdimin e sigurimit të ofertave dhe vazhdimin e vlefshmërisë-validitetit të ofertave, kur ju në cilësinë e autoritetit kontraktues nuk na keni dërguar ndonjë kërkesë që të bëjmë vazhdimin e tyre.
Në dokumentet që i pranuam më datë 31/08/2020 nuk pamë ndonjë e-mail apo shkresë zyrtare të drejtuar në adresen e kompanisë tonë, ku do të shihej se ju në cilësinë e autoritetit kontraktues keni kërkuar vazhdimin e vlefshmërisë-validitetit të ofertave, përkatësisht vazhdimin e sigurimit të ofertave kur ju në cilësinë e autoritetit kontraktues nuk na keni dërguar ndonjë kërkesë që të bëjmë vazhdimin e tyre.
Derisa në Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Pubik Neni 29 Sigurimi i Tenderit, përkatësisht neni 31 Validiteti i Tenderit

29. Sigurimi i Tenderit

29.6 Sigurimi i tenderit do të qëndroj valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas skadimit të periudhës së validitetit të tenderit.

29.7 Afati i fundit për dorëzim të sigurimit të tenderit do të jetë i njëjtë si ai për dorëzim të tenderëve. Sigurimet e tenderëve të pranuara pas afatit për dorëzimin e tenderit do të refuzohet dhe kështu do të rezultojë në refuzimin e tenderit.

29.8 AK do të konfiskoj sigurimin e tenderit në situatat e mëposhtme:

1. AK konstaton që OE ka dorëzuar informata të pavërteta ose mashtruese;
2. OE tërheq tenderin e tij pas afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, por para skadimit të periudhës së validitetin të tenderit; dhe
3. OE fiton kontratën por refuzon ose dështon:
a. Të ofroj sigurimin e ekzekutimit, siç specifikohet në DT;
b. Të respektoj kushtet tjera që paraprijnë nënshkrimin e kontratës, siç specifikohet në DT; ose
c. Të performoj kontratës, sipas specifikimeve në DT.

29.9 Sigurime e tenderëve do të lirohen dhe kthehen te OE, brenda 5 ditë, në situatat në vijim:

- Data e skadimit të validitetin të tenderit;
- Kontrata është dhënë dhe ka hyrë në fuqi;
- Anulim ose përfundim të aktivitetit të prokurimit para dhënies ose hyrjes në fuqi; ose
- Pas tërheqjes së një tenderi para afatit të fundit për dorëzim të tenderit përveç nëse theksohet në DT që nuk lejohen tërheqje të tilla.

31. Validiteti i Tenderit

31.1. Autoritetet kontraktuese duhet të cekin në dosjen e tenderit periudhën e vlefshmërisë së tenderit të kërkuar dhe të specifikuar si numër i ditëve kalendarike nga afati i fundit për dorëzimin e tenderëve.

31.2 Kërkesa për periudhë të validitetit të tenderit do të jetë:

- Në minimum 90 ditë për kontrata me vlerë të madhe;
- Në minimum 60 ditë për kontrata me vlerë të mesme; dhe
- Në minimum 30 ditë për kontrata me vlerë të vogël.

31.3 Periudha e validitetit të tenderit e specifikuar në dosjen e tenderit do të ndryshoj varësisht nga kompleksiteti i prokurimit. Periudha e kërkuar e validitetit do të jetë jo më shumë se që është e nevojshme, dhe do të jetë e mjaftueshme për AK të bëjë vlerësimin e tenderëve të pranuar dhe të bëjë dhënien dhe nënshkrimin e kontratës.

31.4 Nën situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetin të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)

31.5 Në përputhje me rrethanat, nga të gjithë tenderët do të kërkohet që gjithashtu të zgjasin validitetin e sigurimit të tenderit të tyre.

31.6 Është e hapur për secilin OE të vendosë nëse dëshiron të përtërijë validitetin e tenderit apo jo. OE të cilët vendosin të mos zgjasin validitetin e tenderëve të tyre do të refuzohet si "të papërgjegjshëm" dhe kështu AK nuk do të konfiskoj Sigurimin e Tenderit të tyre.

Në rubriken pyetje të shpeshta në ballinen e KRPP-së në numrin rendor 69 e datës 06/02/2020 gjendet edhe kjo pyetje si dhe përgjigja e dhënë nga shërbimet përkatëse - Departamenti i Rregullave të KRPP-së

69. 06.02.2020. Periudha e validitetit të ofertës ka skaduar derisa lënda ka qenë në shqyrtim në OSHP dhe aktiviteti i prokurimit ka qenë në pezullim. A mund të nënshkruhet një kontratë publike pa validitet të ofertës?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, KRPP ofron interpretimin ligjor si në vijim:

Neni 31.3 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP), përcakton:

"31.3 Periudha e validitetit të tenderit e specifikuar në dosjen e tenderit do të ndryshoj varësisht nga kompleksiteti i prokurimit. Periudha e kërkuar e validitetit do të jetë jo më shumë se që është e nevojshme, dhe do të jetë e mjaftueshme për AK të bëjë vlerësimin e tenderëve të pranuar dhe të bëjë dhënien dhe nënshkrimin e kontratës".

Neni 31.4 i RRUOPP, përcakton:

"31.4 Nën situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)"

31.5 Në përputhje me rrethanat, nga të gjithë tenderët do të kërkohet që gjithashtu të zgjasin validitetin e sigurimit të tenderit të tyre.

Sipas nenit 31.4 të lartcekur, nuk përcaktohet sa ditë para skadimit të validitetit të ofertave mund të kërkohet zgjatja e afatit të validitetit të ofertave. Megjithatë, është e rëndësishme që të ketë kontinuitet midis afatit të skaduar dhe atij të ri, për këtë arsye në këtë dispozitë thuhet: "para datës së skadimit...."

Pavarësisht se aktiviteti i prokurimit është në "Pezullim", AK në përputhje me nenin 31.4 të RRUOPP duhet që të kërkojë zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit.

Asnjë dispozitë e LPP-së dhe e legjislacionit dytësor nuk përcakton përkufizimin e fjalës "Pezullim", megjithatë KRPP konsideron se fjala "Pezullim" në kuptim të këtij ligji duhet të nënkuptojë mosndërmarrjen e ndonjë hapi në procedurat e prokurimit për derisa aktiviteti i prokurimit është i pezulluar. (Psh: hapja e tenderëve nuk duhet të bëhet nëse aktiviteti i prokurimit është pezulluar si rezultat i Kërkesës për rishqyrtim e parashtruar në AK, apo e një ankese e parashtruar në OSHP gjatë fazës së tenderimit, apo nënshkrimi i kontratës nuk duhet të bëhet për deri sa aktiviteti i prokurimit është në pezullim si rezultat i parashtrimit të një kërkese për rishqyrtim në AK, apo një ankese në OSHP)

Neni 31.3 i RRUOPP kërkon rreptësishtë që oferta të ketë validitet deri te dhënia dhe nënshkrimi i kontratës. Prandaj KRPP konsideron se asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës.

Për këtë arsye, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit duhet me kujdesin më të madh të përcjellë

validitetin e ofertave, dhe në çdo rast duhet të kërkojë nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Në mënyrë retroaktive nuk mund të kërkohet zgjatja e validitetit të ofertave dhe/ose e sigurisë së tenderit.

KRPP do të monitorojë me kujdesin e veçantë autoritetet kontraktuese për moszbatimin e nenit 31.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik dhe do të shqiptojë "Vërejtje me shkrim" në përputhje me Nenin 5, paragrafin 7 të Rregullores Nr. 2/2017 për Procedurat e Dhënies dhe Revokimit të Certifikatës Profesionale për Prokurimin Publik.

22. Periudha e Vlefshmërisë se Tenderit

Tenderët do të mbeten të vlefshme për aq kohë sa është e shënuar në FDT. Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të filloj në datën e afatit të fundit te dorëzimit te tenderëve. Një tender që është valid për një kohë më të shkurtër, do të refuzohet nga Autoriteti Kontraktues si jo e përgjegjshme.
Në rrethana të jashtëzakonshme, para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga tenderuesit zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së tenderëve të tyre.
Kërkesat dhe përgjigjet duhet të bëhen me shkrim. Nëse Sigurimi i Tenderit kërkohet ajo do të zgjatet edhe për një periudhë përkatëse. Dështimi për t'iu përgjigjur kërkesës së bërë nga autoriteti kontraktues do të çojë në refuzimin e tenderit, pa konfiskim të Sigurimit të Tenderit të tij.

Me datë 18/07/2019 plotësisht me arsye autoriteti kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme, Ndërtesa Qëndrore e MPB-së Rr. Luan Haradinaj 10 000 Prishtinë Republika e Kosovës; e ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit dhe ka shkruar këtë arsyetim:

"Gjatë fazës së ri-vlerësimit është kuptuar se kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale edhe specifikimet teknike të përcaktuara në dosjen e tenderit sipas standardit DIN 74069 (që i referohet edhe regullorës për regjistrimin e automjeteve dhe targave gjermane) është në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Specifikimet teknike) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92, si dhe të nenit 20 Specifikimet Tenike të RRUOPP, gjë e cila është e konfirmuar edhe me interpretimin ligjor i dates 11/07/2019 nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP).
Prandaj ky aktivitet i prokurimit ANULOHET bazuar në nenin 62, paragrafi 1.1 të ligjit për Prokurim Publik".

Është krejtsisht e pa kuptueshme se si autoriteti kontraktues MPB-ja, përkatësisht Departamenti i Prokurimit i udhequr nga drejtori i këtij departamenti ka mundur që për këtë aktivitet të prokurimit të propozoi që oferta e operatorit ekonomik G.S.G SH.P.K. & KIG d.d. &KIG d.o.o Hyzri Talla, Qendra Tregtare 10000 Prishtinë të shpërblehet me kontratë publike edhe përkundër parregullësive të evidentuara gjatë fazës së vlerësimit të ofertave si dhe pas nxjerrjes së interpretimit ligjor të KRPP-së duke u bazuar në përgjegjësit që ka sipas nenit 87, paragrafet2.3 dhe 2.8

Me datë 18/07/2019 plotësisht me arsye autoriteti kontraktues Ministria e Punëve të

Brendshme, Ndërtesa Qëndrore e MPB-së Rr. Luan Haradinaj 10 000 Prishtinë Republika e Kosovës; e ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit dhe ka shkruar këtë arsyetim:

"Gjatë fazës së ri-vlerësimit është kuptuar se kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale edhe specifikimet teknike të përcaktuara në dosjen e tenderit sipas standardit DIN 74069 (që i referohet edhe regullorës për regjistrimin e automjeteve dhe targave gjermane) është në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Specifikimet teknike) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92, si dhe të nenit 20 Specifikimet Tenike të RRUOPP, gjë e cila është e konfirmuar edhe me interpretimin ligjor i dates 11/07/2019 nga **Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP).**
Prandaj ky aktivitet i prokurimit ANULOHET bazuar në nenin 62, paragrafi 1.1 të ligjit për Prokurim Publik".

Provë: Interpretimi i KRPP-së i datës 11/07/2019 në kërkesen e Departamentit të Prokurimit i autoritetit kontraktues MPB-ja

Nga të gjtha këto që u shtjelluan në këtë ankesë si dhe në Kërkesën për rishqyrtim të parashtruar pranë autoritetit kontraktues shihet kjart së eksperti shqyrtues i OSHP-së e ka vu në lajthitje Panelin shqyrtues të OSHP-së "Diferenca në mes të kërkeses së dosjes së tenderit dhe rezultatit nga mostrat e marra për verifikim në laboratorin nga Agjencioni i Forenzikës dalin rezultate shumë të përafërta, me këtë rast konstatojmë rezultatet e matjeve të targave të automjeteve të dorëzuara në laboratorin e Agjencionit të Forenzikës së Kosovës paraqesin ndryshimin e tyre në matje krahasuar me kërkesat e dosjes së tenderit, por këto ndryshime nuk shkatojnë devijime nga karakteristikat e tyre, që do të thotë nuk paraqesin ndonjë pengesë në zhvillimin e komunikacionit, rrjedhimisht për syrin e njeriut ky devijim është i padukshëm."
Sipas këtij konstatimi eksperti i OSHP- z. Bibaj na qenka më ekspert dhe më profesionist se sa ekspertët e Agjencionit të Forenzikës së Kosovës të cilët kanë kualifikime përkatëse si dhe përcjellin trajnime sipas nevojës për përdorimin e pajisjeve të laboratorit përkatës të cilat pajisje janë shumë të përsosura të Forenzikës i cili sjellë rezultate shumë më të ndieshme dhe më të sakta se këto.

Derisa eksperti i OSHP z. Bibaj thotë: **"rrjedhimisht për syrin e njeriut ky devijim është i padukshëm.".**
Sipas tij nëse syri i njeriut diçka të tillë nuk qenka në gjendje me vërejtë le të mbetet ashtu se ne jemi mësuar me devijime të tilla dhe pa iu përmbajtur standardeve përkatëse qoftë sandardeve të Republikës së Kosovës apo ndonjë standardi të Bashkimit ***Evropian e jo standardit të ndonjë shteti si në rastin konkret standardit të Gjermanisë.***

Konstatim përfundimtar që ka të bëjë me ankesen

Edhe pse oferta e N.P.G "Malsia" 600049622 Gurrakoc, është ofertë e përgjegjshme me çmimin më të ulët ashtu siç është kërkuar në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e tenderit, rrjedhimisht ky aktivitet ishte dashur të anulohet duke pasur parasysh parregullësitë të cilat e kanë përcjellë këtë aktivitet të prokurimit duke filluar nga specifikimet teknike të cilat rregullohen me nenin 28 Është shkelur neni 28 i Ligjit të

Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Specifikimet teknike) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,
-Është shkelur neni 20 i RRUOPP-së (Specifikimet Teknike), si parregullësitë lidhur me 31.4 Nën situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderuesit të pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)"

Në përfundim të prezentimit të argumenteve përmes kësaj Ankese kërkojmë nga eksperti shqyrtues i OSHP-së që t'i propozoi Panelit Shqyrtues të OSHP-së të aprovojnë Ankesën e Kompanisë 'N.P.G "Malsia" 600049622 Gurrakoc dhe i tërë aktiviteti i prokurimit të Anulohet dhe të urdhëhohet autoriteti kontraktues Mininistria e Punve të Brendshme - Departamenti i Prokurimit të bie këtë:

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

Prandaj duke konsideruar se me vendimet e ankimuara AK ka vepruar në kundërshtim me aplikimin e dispozitave ligjore të lartshënuara të - Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Specifikimet teknike) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,LPP-së dhe akteve tjera nënligjore që si pasojë nga shkeljet e pretenduara ka rezultuar me dëmtimin e Operatorit Ekonomik "N.P.G "Malsia" Gurakoc, Gurrakoc 600049622 kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i KRPP-së pas shqyrtimit të kësaj Ankese si dhe oferten e operatorit ekonomik e cila është propozuar që të shpërblehet me kontratë publike për aktivitetin e lartëcekur të prokurimit pas shqyrtimit dhe marrjes në konsideratë duke iu dhënë peshë të gjitha fakteve përkatësisht parregullësive të paraqitura në ankesë - kërkesë për Rishqyrtim dhe pas veprimeve korrigjuese, i propozojmë të merr këtë:

V E N D I M

- MIRATOHET si e bazuar Ankesa e Operatorit Ekonomik "N.P.G "Malsia" Gurakoc, Gurrakoc 600049622;

- ANULOHET Vendimi, përkatësisht Njoftimi për dhënie të kontratës i autoritetit kontraktues i publikuar në ueb faqen e platësormes elektronike të KRPP-së me datë 18/12 /2020;

- ANULOHET Vendimi – Letër standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 18/12/2020 "N.P.G "Malsia" Gurakoc, Gurrakoc 600049622 Republika e Kosovës të mirren masa adekuate korrigjuese për eliminimin e lëshimeve ligjore dhe të vendoset që aktiviteti i prokurimit me titull: ''Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteve-ritender", pas ri-vlërsimit të anulohet aktivitetit i ptokurimit dhe të rishpallet një aktivitet i ri

- ANULOHET Vendimi përpatësisht përgjigja e autoritetit kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme, Ndërtesa Qëndrore e MPB-së Rr. Luan Haradinaj 10000 Prishtinë Republika e Kosovëse datës 24/12/2020

9. ***Dëmet materiale***

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale janë të mëdha që kanë të bëjnë: - Me përgatitjen e dosjes së tenderit, - Përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim, - Përgatitjen e kësaj ankese. - Dëmet e tërsishme do të konstatohen më vonë nga ekspertet e kompanisë dhe ekspert të pavarur.

10. ***Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura***

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës"
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*